



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.40

2005

8 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Rregullore e MRRTT	Për procedurat dhe kriteret e licencimit të personave fizike dhe juridikë si vlerësues të pasurive të paluajtshme.....	1431
Vendim i GJL nr.7, datë 24.3.2005	Me objekt kundërshtimin e vendimit nr.159, datë 26.11.2003 të K K Pronave, Vlorë	1443
Udhëzim i KQZ nr.12, datë 24.5.2005	Për procedurën e hedhjes së shortit për caktimin e mandatit të fundit nga listat shumëmemërore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.....	1448
Udhëzim i KQZ nr.13, datë 26.5.2005	Për procedurën e organizimit të shortit, për shpalljen e fituesit midis kandidatëve që kanë marrë numër të barabartë votash në zonën njëmemërore.....	1450
Udhëzim i KQZ nr.14, datë 28.5.2005	Për një ndryshim në udhëzimin nr.4, datë 23.3.2005 për caktimin e vendit të numërimit të votave, përgatitjes së tyre dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit.....	1451
Udhëzim i KQZ nr.15, datë 28.5.2005	Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Qendrës së Votimit	1453

RREGULLORE

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E LICENCIMIT TË PERSONAVE FIZIKË DHE JURIDIKË, SI VLERËSUES TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

**Miratuar me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit
nr.103, datë 23.5.2005**

KREU I OBJEKTI

Neni 1

Kjo rregullore ka për objekt:

- Organizimin e strukturave, përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe kompetencave ligjore në fushën e licencimit të personave fizikë dhe juridikë për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.
- Mënyrën e realizimit të të drejtave që kanë personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj për t'u pajisur me licenca profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, si dhe ndryshimet që u bëhen më pas këtyre licencave.

KREU II KOMISIONI I POSAÇËM I DHËNIES SË LICENCEVE

Neni 2

Licencat profesionale për veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë në vlerësimin e pasurive të paluajtshme, jepen nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.259, datë 28.4.2005 "Për licencimin e personave fizikë e juridikë, si vlerësues të pasurive të paluajtshme".

Komisioni i Posaçëm për Dhënien e Licenceve Profesionale për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme është organi i vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë që ka të drejtën e dhënies së licencave për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË POSAÇËM

Neni 3

Komisioni i Posaçëm për Dhënien e Licenceve Profesionale për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme dhe shpërblimi, miratohet me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Në këtë Komision marrin pjesë si anëtarë:

- 4 përfaqësues nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë;
- 1 përfaqësues nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- 1 përfaqësues nga Shoqata e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme;
- 1 përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Neni 4

Komisioni përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretaria e Komisionit.

Komisioni kryesohet nga kryetari dhe, në mungesë e me porosi të tij, nga zëvendëskryetari i Komisionit.

Komisioni, si rregull, mbledhet një herë në dy muaj në vartësi të kërkesave dhe problematikës së paraqitur. Data e mbledhjes dhe rendi i ditës bëhen të ditur të paktën 3 ditë përpara.

Në rastet kur shihet e arsyeshme, kryetari mund të mbledhë Komisionin jashtë radhës.

Komisioni merr vendime që ka të bëjë me licencimin e subjekteve që plotësojnë kërkesat për marrjen e licencës profesionale, konform kësaj rregulloreje.

Vendimet merren në mbledhjen e Komisionit me votim. Në rastin e një votimi të barabartë, vota e kryetarit të Komisionit është përcaktuese.

Procesverbali i mbledhjes dhe vendimi i Komisionit hartohet dhe miratohet sipas përcaktimit në nenin 10 të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Komisioni, në mbledhjen e tij, shqyrton dhe materialet e ndryshme të ardhura, zyrtarisht, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit nga gjykatat, bankat, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme e institucione të tjera.

Komisioni, pas shqyrtimit të problemeve të bëra prezent, merr vendime dhe bën propozime për masa konkrete ndaj shkeljeve të konstatuara dhe, sipas rastit, bëhen verifikime për problemin e paraqitur.

Procedurat për vendosjen e masës, lloji i masës së marrë ndaj subjektit dhe afatet përcaktohen në nenin 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Për punën e kryer, kryetari i Komisionit shpërblehet me shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe anëtarët e Komisionit dhe të sekretarisë shpërblehen në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë secili, për çdo mbledhje.

Neni 7

Komisioni, për çështje që do të shqyrtohen, sipas objektit dhe materialit, të cilat kanë nevojë për informacion të mëtijshëm apo verifikim, fton specialistë të fushës (ekspertë).

Përbërja e grupit të ekspertëve dhe masa e shpërblimit të tyre përcaktohet me urdhër të Ministrit, sipas rastit.

Specialistët përgatisin mendimin me shkrim dhe dorëzohet në sekretarinë e Komisionit, e cila ia paraqet Komisionit në mbledhjen e radhës, për të marrë vendimet përkatëse.

KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SEKRETARISË SË KOMISIONIT

Neni 8

Funksionin e sekretarisë së Komisionit të Licencave për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme e kryen përgjegjësi i sektorit të lejeve të veprimtarive të ndërtimit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe një specialist i këtij sektori.

Kërkesat dhe dokumentacioni i nevojshëm, i subjekteve të interesuara, dërgohen në rrugë postare pranë sekretarisë së Komisionit, nëpërmjet Zyrës së Protokollit, në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 9

Sekretaria verifikon rregullshmërinë ligjore të dokumentacionit të paraqitur, sipas kësaj rregulloreje, dhe përgatit materialin për mbledhjen e Komisionit, duke dhënë edhe mendimin për vendimin që duhet të marrë Komisioni.

Sekretaria e Komisionit ka të drejtën e komunikimit zyrtar me subjektin që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e dokumentacionit, sipas kësaj rregulloreje, deri në marrjen e licencës.

Sekretaria, materialin përfundimtar duhet ta vërë në dispozicion të antarëve të Komisionit, jo më vonë se 3 ditë përpara ditës së mbledhjes së Komisionit.

Neni 10

Sekretaria e Komisionit mban lidhje të vazhdueshme zyrtare me të gjitha institucionet dhe subjektet që kanë të bëjnë me aktivitetin e subjekteve në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, duke relatuar me shkrim te kryetari i Komisionit për këto probleme.

Neni 11

Sipas vendimeve të marra nga Komisioni i licencave të dokumentuara në procesverbalin e mbledhjes, sekretaria përgatit vendimin përkatës, që firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit prezent në ditën e mbledhjes.

Vendimi i Komisionit miratohet me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Neni 12

Mbi bazën e vendimeve të miratuara të Komisionit, sekretaria përgatit licencat profesionale në 2 (dy) kopje origjinale, sipas formatit të miratuar.

Njëra nga licencat, që mbahet në arkivën e sekretarisë, kundërfirmohet nga sekretaria e Komisionit. Pas nënshkrimit nga kryetari Komisionit të licencave, kopja origjinale e licencës i dorëzohet personit fizik apo përfaqësuesit të autorizuar të subjektit juridik, pasi të ketë bërë më parë pagesën e tarifës përkatëse.

Neni 13

Për pajisjen me licencë në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme profesionale, subjektet paguajnë tarifën e pakthyeshme, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Lista e subjekteve që licencohen i vihet në dispozicion Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.

Neni 14

Në mbledhjen e radhës të Komisionit, nga sekretaria, paraqiten për shqyrtim dokumentet e pranuar deri 20 ditë para datës së mbledhjes.

Përgjigjet për miratimin e licencave nga Komisioni, jepen nga sekretaria pas zbardhjes së vendimit.

Neni 15

Veprimet që kryhen nga sekretaria pa kaluar në Komision

Sekretaria e Komisionit ka të drejtë që të shqyrtojë dhe të vendosë për kërkesat e subjekteve, që kërkojnë të ndryshojnë emërtimin e subjektit, selinë, drejtuesin ligjor dhe çregjistrimin e subjektit, pa kaluar në komision, duke hartuar për këtë një procesverbal të veçantë.

Neni 16

Licenca është një dokument juridik, profesional, e cila e lejon disponuesin e saj të ushtrojë veprimtari në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Komisioni jep dy lloje licencash:

- Licencë personale e personit fizik,
- Licenca për një shoqëri si person juridik, e cila jepet në bazë të licencës personale të personit fizik.

Neni 17

Licenca përmban këto elemente:

- a) Numrin e regjistrimit në regjistrin themeltar;
- b) Emrin e personit fizik kur licenca është personale si vlerësues;
- c) Emrin e personit juridik, drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, që është personi fizik, i licencuar si vlerësues të pasurive të paluajtshme;
- d) Numrin dhe datën e vendimit të Komisionit;
- e) Shkallën e vlerësimit që i jepet personit fizik dhe juridik;
- f) Afatin për licencat e shoqërive;
- g) Fotografinë e personit që licencohet;
- h) Elementet e sigurisë;
- i) Numrin dhe datën e mandatarëkëtitimit të tarifës;

Licencat e personave fizikë dhe juridikë, në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, jepet për këto sende të paluajtshme:

- a) Për ndërtesat dhe tokë truall;
- b) Për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrutshme.

Licencat e subjekteve për secilën fushë të vlerësimit të pasurive të paluajtshme jepen në dy shkallë:

Shkalla e parë ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e vlerësimit pa asnjë kufizim.

Shkalla dytë ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e vlerësimit ose duke punuar pranë një shoqërie që ka vlerësues të shkallës së parë të punësuar ose nën mbikëqyrjen e një vlerësuesi të shkallës së parë.

Çdo person fizik dhe juridik i fiton shkallët në licencë në bazë të rezultateve të arritura, përvojës në punë etj., sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Licenca e shkallës së parë fitohet kur:

- personi që kërkon të licencohet ka një përvojë në profesion mbi 10 vjet nga diplomimi dhe jo më pak se 3-5 vjet nga përfundimi i kursit të kualifikimit për vlerësim të pasurive të paluajtshme.

Licenca e shkallës së dytë përfitohet kur:

- personi që kërkon të licencohet ka një përvojë mbi 5 vjet nga diplomimi.

Formati i licencës miratohet nga Ministri Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe i bashkëngjitet kësaj rregulloreje.

Neni 18

Licenca nuk lejohet të transferohet nga një person fizik a juridik te tjetri.

Licenca për personat juridik jepet për një afat 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi, ndërsa për personat fizikë licenca është e përhershme.

Pajisja e personave, juridikë e fizikë, me licencë profesionale të bëhet brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë, të përcaktuar në këtë rregullore.

KREU V

KRITERET QË DUHET TË PËRMBUSHIN PERSONAT FIZIKË OSE JURIDIKË PËR T'U PAJISUR ME LICENCË PROFESIONALE

Neni 19

Licencë profesionale individuale (personale):

Të drejtën për të kërkuar pajisjen me licencë për ushtrim profesioni për vlerësimin e pasurive të paluajtshme e kanë personat që kanë kryer kurse të njohura kualifikimi për këtë fushë, në përputhje me standardet europiane dhe praktikat ndërkombëtare për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të miratuara nga organet kompetente, dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë profesionale personale, si vlerësues të *ndërtesave dhe tokës truall*, duhet të jetë i diplomuar në degët e fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në degët e Fakultetit të Ekonomisë.

- Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë profesionale personale, si vlerësues të *tokës bujqësore*, duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin e Agronomisë ose në degët e Fakultetit të Ekonomisë Agrare.

- Personi fizik që kërkon të pajiset me licencë profesionale personale, si vlerësues i *tokës pyjore, tokës kullotë, tokës livadh dhe të tokës së pafrutshme* duhet të jetë i diplomuar në Fakultetin e Agronomisë, Inxhinierisë Pyjore ose në degët e Fakultetit të Ekonomisë Agrare.

Personat fizikë që kërkojnë të pajisen me licencë profesionale personale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme që nuk janë të diplomuar në degët e përcaktuara më lart, mund të licencohen në rast se kanë fituar gradën përkatëse apo kualifikim pasuniversitar të organizuar nga institucione arsimore publike e jopublike në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Personat fizikë që kërkojnë të pajisen me licencë profesionale personale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, krahas plotësimit të kërkesave të veçanta të përcaktuara më lart, duhet të plotësojnë edhe këto kushte të përgjithshme:

- Të mos jenë drejtues teknikë në shoqëri të licencuara për zbatim, projektim, mbikëqyrje, kolaudim dhe shërbime publike.

- Të mos jenë të dënuar apo të mos jetë në proces ndjekjeje ligjore, për shkak të ushtrimit të aktivitetit të tij si vlerësues.

- Të pranojnë, të njohin dhe të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe standardet europiane (ose ato ndërkombëtare) të aprovuara këto nga organet kompetente, për vlerësimin e sendeve të paluajtshme, nëpërmjet një deklarate noteriale.

Për personat që janë diplomuar jashtë vendit ndiqet procedura e njësimit të diplomave të tyre sipas dispozitave në fuqi.

Licencë profesionale shoqërie, si person juridik:

Personat juridikë, vendas apo të huaj, që kërkojnë të pajisen me licencë profesionale shoqërie, duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) Të jenë shoqëri të themeluara e të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar.

- b) Të kenë në përbërjen e tyre të paktën një vlerësues, person fizik të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

Shoqëria përfiton shkallën e vlerësimit që ka vlerësuesi apo vlerësuesit me shkallën më të lartë të përfshirë në shoqëri.

Neni 20

Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën për pajisjen e personave fizikë me licencë profesionale, personale

Kërkesa për miratimin e licencës profesionale personale duhet të përmbajë:

1. Kërkesa me shkrim në formë autobiografie, me këto të dhëna:

- a) Emri, atësia, mbiemri, kombësia, datëlindja, vendlindja, adresa, vendi i punës dhe puna që kryen, numri i telefonit dhe dy kopje fotografi 3x4 cm;

- b) Llojet e veprimtarisë që kërkon të kryejë sipas shkallëve;

- c) Aktiviteti i punës së kryer që nga marrja e diplomës.

2. Kopje të diplomës.

3. Certifikatë lindjeje me fotografi.

4. Deklaratë noteriale që njeh dhe do të zbatojë kushtet, rregullat e kodit të veprimit të standardeve europiane të aprovuara për vlerësimin e pasurive(sendeve) të paluajtshme nga organet kompetente.

5. Deklaratë noteriale për mosqenien si drejtues teknik në shoqëri të licencuar për zbatim, projektim, mbikëqyrje kolaudim dhe shërbime publike.

6. Dëshmi kualifikimi në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, për rastet e parashikuara në nenin 19, të kësaj rregullorje.

7. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor për problemet e fushës ku kërkon të licencohet.

8. Vërtetim nga prokuroria ku të vërtetohet se nuk është në ndjekje penale.

Neni 21

Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën për pajisjen e shoqërive, persona juridikë me licencë profesionale

Kërkesa për pajisjen me licencë profesionale të shoqërive, duhet të përmbajë:

1. Kërkesë me shkrim e të drejtues ligjor ku të jepen këto të dhëna:

a) Emri, atësia, mbiemri, kombësia, datëlindja, vendlindja, adresa, vendndodhja e drejtuesit ligjor të shoqërisë dhe një autobiografi të shkurtër të shoqërisë dhe aktivitetin që do të ushtrojë shoqëria.

2. Vendimin e regjistrimit të shoqërisë në gjykatë me objekt ushtrimin e veprimtarisë në fushën e vlerësimit të pasurive (sendeve) të paluajtshme.

3. Kopje e licencës profesionale të vlerësuesit, personit fizik ose të të punësuarve në shoqëri si vlerësues, e noterizuar.

4. Statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë.

5. Kontratën e punës, të lidhur para noterit midis drejtuesit ligjor të shoqërisë dhe vlerësuesve që punësohen pranë saj.

6. Deklaratën noteriale të vlerësuesve që punësohen pranë shoqërisë që nuk janë të punësuar si të tillë, apo dhe si drejtues teknik në shoqëri të licencuar për zbatim, projektim, mbikëqyrje kolaudim dhe shërbime publike, në shoqëri të tjera.

7. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria për drejtuesin ligjor.

Neni 22

Dokumentet që duhen për ndryshimin e emërimit të shoqërisë

Kërkesa për ndryshimin e emërimit të shoqërisë duhet të përmbajë:

1. Kërkesë me shkrim nga drejtuesi ligjor për arsyen e këtij ndryshimi.

2. Vendimin e regjistrimit në gjykatë mbi këtë ndryshim.

3. Vërtetim i degës së tatim-taksave dhe organit të qeverisjes vendore, ku subjekti është rezident, për shlyerjen e detyrimeve fiskale.

4. Kontratë e lidhur para noterit e vlerësuesit, apo vlerësuesve të shoqërisë, për vazhdimin e aktivitetit me shoqërinë me emërtim të ndryshuar.

Neni 23

Dokumentet që duhen për rinovimin e licencës të personave juridikë

Kërkesa për rinovimin e licencës së shoqërisë duhet të përmbajë:

1. Kërkesë me shkrim, ku të paraqitet aktiviteti i ushtruar gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

2. Kontrata e rinovuar, e lidhur para noterit me vlerësuesin/it të licencuar të shoqërisë.

3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale, lëshuar nga degët e tatim-taksave dhe njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti është rezident.

Licenca e rinovuar do t'i jepet shoqërisë, person juridik, vetëm pasi të dorëzojë licencën origjinale të mëparshme, në momentin e tërheqjes së licencës së re.

Neni 24

Kriteret dhe dokumentet që duhen për ndryshimin e shkallës së vlerësimit

Përsnat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të kërkojnë ndryshim nga shkalla e dytë në shkallën e parë pas një periudhe prej 5 vjetësh si vlerësues të shkallës së dytë.

Kërkesa për ndryshimin e shkallës së vlerësimit, duhet të përmbajë:

1. Kërkesë me shkrim, ku të paraqitet aktiviteti i ushtruar gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.
 2. Një listë me objektet e vlerësuar, shoqëruar me vërtetimet e institucioneve, apo personave fizikë (për këto të fundit përpara noterit) për llogari të të cilëve janë kryer këto vlerësime.
 3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale, i lëshuar nga dega e tatim-taksave dhe njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti është rezident.
 4. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria.
- Licenca e mëparshme do të dorëzohet në momentin e tërheqjes së licencës së re.

Neni 25

Dokumentet që duhen për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë (çregjistrimi)

Kërkesa për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë duhet të përmbajë:

1. Kërkesë me shkrim nga drejtuesi ligjor apo personi i autorizuar prej tij për çregjistrimin e shoqërisë nga libri themeltar i regjistrimit.
2. Licencën origjinale që disponon subjekti.
3. Vendimin e gjykatës për mbylljen e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme.
4. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, i lëshuar nga dega e tatim-taksave dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku subjekti është rezident.

Sekretaria kryen veprimet për çregjistrimin e subjektit, duke vënë në dijeni për këtë Komisionin, në mbledhjen e radhës, si dhe njofton zyrtarisht Shoqatën e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.

KREU VI

Neni 26

Regjistrimi i licencave

Të gjitha të dhënat për licencat që u janë dhënë personave fizikë dhe juridikë, regjistrohen në një regjistër të veçantë i cili mbahet në sektorin e licencave.

Sekretaria ruan në arkivë licencën profesionale, së bashku me praktikat shkrese.

Çdo subjekt ka të drejtë të konsultohet me të dhënat e regjistrit të veçantë.

KREU VII

Neni 27

Masat që do të merren në raste shkeljesh

Komisioni i Posaçëm shqyrton në mbledhjet e tij të gjitha rastet e konstatuara dhe të njoftuara nga institucione të ndryshme për kundërvajtje administrative të personave fizikë e juridikë, të licencuar, gjatë ushtrimit të aktivitetit të vlerësuesve të pasurive (sende) të paluajtshme.

Komisioni, pas shqyrtimit dhe verifikimit lidhur me shkeljet e konstatuara dhe duke marrë parasysh edhe shkallën e shkeljes, merr vendime ndaj personave fizikë e personave juridikë të licencuar duke vendosur sanksione si më poshtë:

- Ulje të shkallës së licencës së vlerësimit në shkallë më të ulët;
- pezullim të përdorimit të licencës për një afat nga 6 muaj deri në 2 vjet.
- Heqje e licencës:

kur:

- ka njoftime të përsëritura nga subjektet publike e jopublike për vlerësim të gabuar të pasurive të paluajtshme.

- Gjatë kryerjes së verifikimeve nga ekspertët e caktuar të kontrolleve nga institucionet shtetërore, konstatohen shkelje të dispozitave ligjore, profesionale, rregullave dhe kodit të etikës së

vlerësuesve të pasurive të paluajtshme.

- Personi i licencuar bëhet i paaftë nga ana shëndetësore, vërtetuar me raport mjekësor.
- Për të gjitha rastet kur Komisioni vendos sanksionet e mësipërme ndaj personave fizikë e juridikë të licencuar bëhen njoftimet në institucionet përkatëse.

Neni 28 **Ankimimi**

Çdo person fizik e juridik, ka të drejten e ankimit te titullari i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, për këto raste:

1. Kur refuzohet kërkesa për pajisje me licencë ndaj personit fizik e juridik;
2. Kur ndaj personit fizik e juridik është marrë një vendim nga komisioni për rastet e përmendura më lart.

Ankimi për pikën 1 dhe 2 bëhet brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit dhe i drejtohet, me shkrim, titullarit të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Titullari i institucionit duhet të shprehet me shkrim brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

Ndaj vendimit të Ministrit, në rast se personi fizik e juridik nuk është dakord, i lind e drejta, që brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të Ministrit, të bëjë ankim në gjykatë.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Dokumentet që kërkohen sipas kësaj rregulloreje paraqiten të daktilografuara në origjinal, dokumentet fotokopje duhet të paraqiten të vërtetuara nga noteri.

Neni 30

Rregullorja nr.1, datë 4.2.2005 “Për procedurat e kriteret që do të zbatohen për dhënien e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme”, miratuar me urdhrin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit nr.39, datë 4.2.2005, shfuqizohet.

Licencat e dhëna subjekteve sipas rregullores nr.4171, datë 6.8.2001 “Për procedurat e kriteret që do të zbatohen për dhënien e licencave profesionale për vlerësimin e pasurive të paluajtshme”, miratuar me urdhrin e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr.156, datë 16.12.2003, janë të pavlefshme. Subjektet e pajisura me licencë sipas kësaj rregulloreje, duhet të paraqesin, në Sekretarinë e Komisionit në Ministrinë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, dokumentacionin për rilicencim.

Neni 31

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. Miratuar me urdhërin e Ministrit nr.103, datë 23.5.2005.

Lidhja 1

TARIFAT E PAGESAVE PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR VLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME

Nr	Lloji licencës	Tarifa e pagesës
1	Licenca personale e shkallës së parë	15 000 lekë

2	Licenca personale e shkallës së dytë	10 000 lekë
4	Ndryshim shkalle vlerësimi për licenca personale	7 000 lekë
5	Licenca shoqërie të shkallës së parë	40 000 lekë
6	Licenca shoqërie të shkallës së dytë	30 000 lekë
8	Rinovim licence shoqërie	15 000 lekë
9	Ndryshim shkalle vlerësimi licenca shoqërie	20 000 lekë
10	Ndryshim formati dhe dublikatë licence	2 000 lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT
Komisioni i Posaçëm i Dhenies së Liçensave
për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme



r. regj. Vp. 0001



ELEMENT
SIGURIE

L I Ç E N S Ë
Profesionale Individuale
(Person fizik)

Miratuar me Vendimin e Komisionit
Nr _____ Date _____ 200_

PËR USHTRIM PROFESIONI NË VLERËSIMIN
E PASURIVE TË PALUAJTSHME
Shkalla e _____

Znj/Z _____

LEJOHET TË USHTROJE AKTIVITETIN E
VLERESUESIT PËR FUSHAT:

“

”

K R Y E T A R I

Bashkim FINO

M.Arketimi Nr _____ datë _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT
Komisioni i Posaçëm i Dhenies së Liçensave
për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme

Nr. regj. **Vsh. 0001**

L I Ç E N S Ë
Profesioanle Shoqërore
(Person Juridik)



ELEMENT
SIGURIE

Miratuar me Vendimin e Komisionit
Nr _____ Date _____ 200_

PËR USHTRIM PROFESIONI NË VLERËSIMIN
E PASURIVE TË PALUAJTSHME
Shkalla _____

Subjekti: _____

Me administrator ligjor: _____
Me vlerësues të liçencuar: _____

LEJOHET TË USHTROJE AKTIVITETIN E
VLERESIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR FUSHAT:

“ _____ ”

E vlefshme deri me _____. _____. _____.

K R Y E T A R I

Bashkim FINO

M.Arketimi Nr ____ datë _____

FAQJA E DYTË

Licencat e subjekteve në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme jepet për këto pasuri të paluajtshme:

- a) Për ndërtesat dhe tokë truall.
- b) Për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadh dhe tokë të pafrutshme.

Shkalla e parë ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e vlerësimit pa asnjë kufizim.

Shkalla dytë ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e vlerësimit ose duke punuar pranë një shoqërie që ka vlerësues të shkallës së parë të punësuar, ose nën mbikëqyrjen e një vlerësuesi të shkallës së parë.

Kjo licencë është dhënë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.259, datë 28.4.2005 “Për licencimin e personave fizikë e juridikë, si vlerësues të pasurive të paluajtshme”.

Kjo licencë është pronë e shtetit shqiptar dhe pas përfundimit të afatit të përdorimit dorëzohet në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Asnjë person fizik apo juridik nuk ka të drejtë ta shesë, ta tjetërsojë, apo ta trashëgojë këtë licencë nga një person apo subjekt te një tjetër.

Çdo person, fizik a juridik, që kryen shkelje të dispozitave ligjore gjatë ushtrimit të aktivitetit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme ndëshkohet sipas ligjeve në fuqi.

VENDIM
Nr.7, datë 24.3.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Vladimir Metani	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 24.3.2005, morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

PADITËSE: Hakile Bedini, në mungesë.

I PADITUR: K K K Pronave, në mungesë.

PERSONA TË TRETË: 1. Thimio Llavdaniti,
2. Sami Kapllani, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Kundërshtim i vendimit nr.159, datë 26.11.2003 të K K K Pronave,
Vlorë

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1854, datë 2.11.2004 ka vendosur:

- Të deklarojë mungesën e juridiksionit gjyqësor të çështjes civile nr.640, datë 23.2.2004 që i përket paditëses Hakile Bedini, i paditur K K K Pronave Vlorë, persona të tretë Thimio Llavdaniti e Sami Kapllani, me objekt kundërshtim i vendimit nr.159, datë 26.11.2003 të KKK Pronave Vlorë, pasi çështja hyn në juridiksionin administrativ.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs paditësja Hakile Bedini, e cila parashtroi si më poshtë:

- Vendimi për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është rrjedhojë e kuptimit e zbatimit të gabuar të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës". Nga përmbajtja e neneve 20 dhe 22 të këtij ligji dallohet qartë që ky ligj, në harmoni me Kodin e Procedurës Civile dhe institutin e fuqisë së ligjit në kohë, nuk ka fuqi prapavepruese në lidhje me të drejtën e ankimit, të ushtruar para daljes së ligjit të ri, si dhe për ankimet të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykatat.

- Gjykata ka zbatuar keq ligjin procedural në lidhje me fuqinë e ligjit në kohë, si dhe juridiksionin e kompetencën.

- Ligji nr.9235, datë 27.9.2004 nuk ka fuqi prapavepruese në lëndë procedurale.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.1.2005 ka vendosur:

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikë gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Thimjo Kondi e Irma Bala e pasi e biseduan atë në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.1854, datë 2.11.2004 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur të deklarohet mungesa e juridiksionit gjyqësor të çështjes me paditëse Hakile Bedinin, të paditur Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave, Vlorë, me objekt kundërshtimin e vendimit nr.159, datë 26.11.2003 të tij, është i pabazuar në ligj, prandaj duhet të prishet dhe çështja të dërgohet në atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

Nga materialet e çështjes rezulton si më poshtë:

Me padinë e datës 6.2.2004, Hakile Bedini ka kundërshtuar vendimin nr.159, datë 26.11.2003 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, Vlorë me të cilin i është refuzuar kërkesa për njohjen e pronësisë dhe kthimin e një shtëpie banimi me përbërje dhe kufij të përcaktuar. Padia është bazuar në nenin 27 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 dhe udhëzimit nr.3, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave.

Pasi janë zhvilluar disa seanca gjyqësore, në seancën e datës 2.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke arsyetuar se ajo duhet të shqyrtohet paraprakisht në rrugë administrative duke iu drejtuar me kërkesë Komitetit Shtetëror për Kthimin e Kompensimin e Pronave, bazuar në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, i cili, pas hyrjes në fuqi në datën 16.9.2004, ka shfuqizuar ligjin nr.7698, datë 15.4.1993.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë në marrjen e këtij vendimi ka pasur parasysh nenin 16/2 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, sipas të cilit: *".... 2. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave verifikon vendimet e komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, të ngritura sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Kërkesa për verifikimin e vendimeve të dhëna paraqitet në mënyrë të motivuar nga organet e qeverisjes vendore ose subjektet e shpronësuara brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Komisioni ka të drejtë të shfuqizojë vendimin administrativ të dhënë ose të kërkojë shfuqizimin e tij në rrugë gjyqësore"*.

Lidhur me problemin nëse shqyrtimi i kërkesave kundër vendimeve të komisioneve të pronave, të marra në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, do të bëhet nga gjykatat apo Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në praktikën gjyqësore janë mbajtur qëndrime të ndryshme. Në rastet kur padia është regjistruar për gjykim pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, si rregull, ka zbatuar nenin 16/2 duke vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Ndërsa për çështjet që kanë filluar të gjykohen dhe janë në shqyrtim para hyrjes në fuqi të ligjit të ri, janë parashtruar mendime dhe janë mbajtur qëndrime të ndryshme, të cilat duhet të unifikohen prej Kolegjeve të Bashkuara.

Kolegji Civil, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin e datës 27.1.2005, ka dërguar çështjen në Kolegjet e Bashkuara, për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. *Në qoftë se një çështje për kundërshtimin e një vendimi të Komisionit të Kthimit të Pronave të dhënë në bazë të ligjit të mëparshëm nr.7698, datë 15.4.1993, ka filluar të shqyrtohet në gjykatë para hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr.9235, datë 29.7.2004, çështja vazhdon të jetë në juridiksionin gjyqësor, apo gjykata duhet të shpallë mungesën e juridiksionit të vet dhe të përcaktojë juridiksionin administrativ të Komitetit Shtetëror të Kthimit e Kompensimit të Pronave?*

2. *Si duhet të veprohet lidhur me juridiksionin në rastet kur çështja për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Pronave të dhënë në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë?*

Lidhur me sa parashtrohet në pikën e parë dhe referuar çështjes në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se ajo është në juridiksionin gjyqësor. Paditësja ka bërë ankim kundër vendimit nr.159, datë 26.12.2003 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-pronarëve në datën 6.2.2004 dhe është regjistruar në gjykatë në datën 12.2.2004. Nëpërmjet kërkesëpadisë, paditësja ka kundërshtuar vendimin e KKK Pronave në gjykatë duke iu referuar ligjit të kohës në fuqi në momentin e ngritjes së padisë, ligj, në të cilin ka bazuar vendimin e tij Komisioni i Kthimit të Pronave si nga pikëpamja materiale, ashtu edhe procedurale. Pra kërkitimi i

paditëses Hakile Bedini, drejtuar K K K Pronave për kthimin e pronës, ashtu edhe vendimi i këtij komisioni që ja ka rrëzuar kërkesën, është bërë në zbatim të ligjit të kohës. Po në atë ligj, paditësja është mbështetur në kërkimin e saj para gjykatës, e cila, sipas nenit 27 të ligjit nr.7698, datë 1993 ka qenë organi kompetent për të verifikuar bazueshmërinë në ligj të vendimit të K K K Pronave.

Gjykata e rrethit, duke iu referuar faktit se gjatë gjykimit të çështjes ka dalë një ligj i ri, i cili shfuqizon të parin, vlerëson se çështja nuk i përket më asaj për gjykim.

Ky vendim i gjykatës ka ardhur si rezultat i një gjykimi sipërfaqësor të raportit mes ligjit të ri, që shfuqizon ligjin e vitit 1993 dhe pasojave që vijnë prej saj.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se është e rëndësishme të kuptohet drejt qëllimi i ligjvënësit kur në nenin 30 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, ka përcaktuar se të gjitha ligjet e mëparshme që lidhen me kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve, shfuqizohen. Me miratimin e ligjit të ri, ligjvënësi s'ka pasur për qëllim të çvlerësojë pasojat që ka sjellë zbatimi i ligjit të vitit 1993, por ta plotësonte atë, për efekte të krijimit të mundësive maksimale për kthimin apo kompensimin e plotë të pronave ish-pronarëve, pa kufizimet që kishte ligji i vjetër dhe ta plotësonte më tej atë edhe lidhur me verifikimin e dyfishtë të mosmarrëveshjeve të lindura më parë apo që do të lindin pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sa sipër, ka qenë detyrim kushtetues për Kuvendin, i cili, sipas nenit 181 të Kushtetutës, duhet të plotësonte legjislacionin për çështjet që lidhen me shtetëzimin e konfiskimin e pronave të kryera para hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Është konceptualisht e gabuar, marrë për bazë sa më sipër, jo thjesht nga pikëpamja procedurale, por edhe në përmbajtje të pranohet sikurse ka vendosur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë se, fakti që ligji i vitit 1993 u shfuqizua me atë të vitit 2004, e bën gjykatën jo kompetente.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se gjykata në zbatim të ligjit të kohës, ka marrë çështjen në shqyrtim në përputhje me kompetencat dhe juridiksionin e saj dhe ka qenë në ushtrim të funksioneve të saj të ligjshme mbështetur në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile dhe dispozitat e tjera ligjore. Edhe se ligji i vitit 1993 është shfuqizuar, ai është ligj i aplikueshëm për pasojat që ka sjellë për atë që nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e vitit 2004.

Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të komisioneve të kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve që janë marrë në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ. Gjykatat këto çështje nuk mund t'i nxjerrin jashtë juridiksionit të tyre, por duhet t'i përfundojnë ato duke iu referuar ligjit të mëparshëm ose të dy ligjeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Me këtë zgjidhje i jepet përgjigje edhe problemit të dytë ngritur për unifikim në rastin kur çështjet janë për shqyrtim në gjykatën e apelit apo në Gjykatën e Lartë.

Veç sa arsyetohet më sipër, për të arritur në këtë përfundim unifikues, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se fuqia prapavepruese e ligjit është lidhur kryesisht me ligjin material dhe ajo nuk është në natyrën e ligjit procedural. Është vetë ligji procedural ai që duhet të përcaktojë se si duhet vepruar me rastin e hyrjes në fuqi të tij. Nisur nga fakti që nuk ka një dispozitë kalimtare në ligjin, 9235, datë 29.7.2004, i cili në vetvete është një ligj që përmban dispozita materiale dhe procedurale, si dhe fakti që marrëdhëniet juridike dhe mosmarrëveshjet për to kanë lindur para hyrjes në fuqi të tij, ligji i aplikueshëm duhet të jetë ligji i kohës. Palët nuk mund të parashikonin se ligji do të ndryshonte dhe se rregullat e vendosura do të ndryshonin pasi organet kompetente kishin ndërruar funksionet e tyre. Të pranosh të kundërtën, është me pasojat të rënda jo vetëm për palët, të cilat gjatë apo në përfundim të ndjekjes së procedurave ligjore, të detyrohen të ndjekin të tjera. Do të krijohet një precedent i rrezikshëm që me akte normative, të zgjidhen çështjet, tashmë në juridiksionin gjyqësor nga organe të tjera jashtë këtij juridiksioni.

Derisa çështja është regjistruar në gjykatë para se të hynte në fuqi ligji i ri e automatikisht e drejta e ankimit kundër vendimeve të komisioneve të kthimit e kompensimit të pronave mund të bëhet në gjykatë, tregon se për këto çështje ishte përcaktuar juridiksioni gjyqësor. Në rastet e tjera edhe se marrëdhënia juridike ka lindur mbi bazën e ligjit të vitit 1993, por nuk ka pasur mosmarrëveshje deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri (pra nuk është paraqitur padi në gjykatë për të kundërshtuar vendimin e komisionit), juridiksioni është përcaktuar, ai administrativ dhe ankimi për pasojë do të drejtohet në Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.

Një përfundim i tillë vjen për shkak të interpretimit gramatikor e logjik të nenit 16/2 të ligjit

nr.9235, datë 29.7.2004 ku thuhet se komisioni ka të drejtë të shfuqizojë vendimet administrative të dhëna ose të kërkojë shfuqizimin e tyre në rrugë gjyqësore.

Jo pa qëllim ligjvënësi ka përcaktuar dy alternativa të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. E para, si kompetencë e komisionit kur atij i drejtohet për herë të parë kërkesa pa filluar procedurat gjyqësore, duke njohur në këtë rast juridiksionin administrativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Nga ana tjetër, kur çështja ka hyrë në juridiksionin gjyqësor për shkak se është bërë konflikt para hyrjes në fuqi të ligjit të ri, komisioni e ushtron funksionin e tij nëpërmjet kërimit në gjykatë të shfuqizimit të vendimit të ankimuar, kur është rasti, pasi çështja është nën autoritetin e juridiksionin e një organi tjetër, gjykatës.

Lidhur me problemet e shtruara për diskutim, ka mendim se është vetë gjykata e jo ligji që çështjen e nxjerr jashtë juridiksionit gjyqësor, se ligji nuk aplikohet automatikisht, por gjykatat në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile, vendosin vetë të nxjerrin çështjen jashtë juridiksionit të tyre. Po të pranohej ky arsytim lind pyetja se si do të veprohet në ato raste kur gjykatat nuk e nxjerrin jashtë juridiksionit çështjen, por e konsiderojnë atë në juridiksionin e tyre dhe do të vazhdonin gjykimin? Do të ndodheshim para një situatë anormale që çështje të njëjta por për nga natyra e mosmarrëveshjes dhe ligjit të aplikuar, e për shkak të disponimeve të ndryshme gjyqësore, t'u nënshtroheshin juridiksioneve të ndryshme.

Në këto kushte, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, është rezultati i aplikimit të gabuar të ligjit e për këtë shkak, vendimi duhet të priset dhe çështja t'i dërgohet asaj gjykate për vazhdimin e gjyimit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë”,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr.1854, datë 2.11.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe dërgimin e çështjes për gjykim në po atë gjykatë.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore e dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kristaq Ngjela, Spiro Spiro, Perikli Zaharia, Agron A.Lamaj, Artan Hoxha, Vladimir Bineri, Evgjeni Sinoimeri, Shpresa Beçaj, Ardian Dvorani.

MENDIMI I PAKICËS

Pakica është e mendimit se zgjidhja e drejtë e çështjes do të ishte lënia në fuqi e vendimit nr.1854, datë 2.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka deklaruar mungesën e juridiksionit gjyqësor të çështjes, pa u ezauruar shqyrtimi paraprak i saj në rrugë administrative nëpërmjet ankimit në Komitetin Shtetëror të Kthimit e Kompensimit të Pronave.

Pakica është e mendimit se të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të komisioneve të Kthimit e Kompensimit të pronave ish-Pronarëve, që janë marrë në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 dhe që janë kundërshtuar dhe janë në shqyrtim në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin administrativ dhe se, pa u ezauruar ankimi dhe shqyrtimi në rrugë administrative, çështjet nuk mund të vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykatat.

Kjo vlen për çështjet që janë në shqyrtim në gjykata deri sa nuk është marrë një vendim i

formës së prerë para se të hynte në fuqi ligji i ri.

Shumica arsyeton se fuqia prapavepruese e ligjit është e lidhur kryesisht me ligjin material dhe ajo ëky koncept] nuk është në natyrën e ligjit procedural. Ky arsyetim është i saktë, por përfundimet që nxirren nuk janë të tilla.

Si ligji nr.7698, datë 15.4.1993, ashtu edhe ligji i ri nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, përmbajnë kryesisht dispozita materiale, por në këto ligje nuk mund të shmangej edhe parashikimi i disa dispozitave me karakter procedural. Pavarësisht se, si ligji i vjetër, ashtu edhe ligji i ri, nuk shprehen në ndonjë dispozitë konkrete për normat materiale që kanë karakter prapaveprues, nga vetë natyra e këtyre ligjeve që rregullojnë marrëdhënie pronësie në një mënyrë të ndryshme nga dispozitat ligjore të kohës së regjimit komunist, si dhe rregullojnë pasojat në dëm të interesave të ish-pronarëve që kanë ardhur prej tyre, duke rivendosur drejtësinë e dhunuar, konkludohet se normat e tyre materiale kanë karakter prapaveprues. Karakter prapaveprues kanë edhe normat materiale të ligjit të ri në raport me ligjin e vjetër, gjersa ligji i ri u sjell ish-pronarëve një spektër më të gjerë përfitimesh (rikthim të të drejtave pronësore apo kompensime). Duke qenë kështu në të gjitha rastet kur pasojat e ardhura sipas ligjit të vjetër nuk janë ezauruar ende me vendime të formës së prerë, në cilën do fazë të gjykimit që mund të ndodhet çështja në kohën e hyrjes së ligjit të ri në fuqi, do të zbatohet ky i fundit në të gjitha rastet kur dispozitat e tij janë më të favorshme për ish-pronarët. Përsa i përket dispozitave procedurale të këtyre ligjeve, në të gjitha rastet për çështjet në shqyrtim në çfarëdo fazë apo shkallë të gjykimit, do të zbatohen dispozitat procedurale të ligjit të ri, që nga momenti i hyrjes së tij në fuqi. Zbatimi i dispozitave procedurale të ligjit të vjetër do të vazhdonte të bëhej në qoftë se një gjë e tillë do të parashikohej në mënyrë të shprehur (eksplicite) në ligjin e ri. Përkundrazi ligji i ri shprehet për shfuqizimin e menjëhershëm dhe në tërësi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, si dhe të një sërë ligjesh të tjera me problematikë të ngjashme (neni 30). Në të njëjtën kohë në nenin 22/2 të ligjit të ri parashikohet se “2. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave rifillon në mënyrën, formën dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj”.

Parashikimet e nenit 16/1 (a) dhe 2 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 janë rregullime të karakterit procedural dhe, si të tilla, ato kanë zbatim të menjëhershëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, si për vendimet e komisioneve vendore që jepen rishtas, ashtu edhe për çështjet që janë duke u shqyrtuar në çdo shkallë të gjykimit, gjersa vendimet nuk kanë marrë formë të prerë.

Dispozitat që parashikojnë juridiksionin për shqyrtimin e një çështjeje kanë karakter procedural. I tillë është edhe neni 16/1 (a) dhe 2 i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004.

Sipas arsytimit të mësipërm kjo dispozitë duhet të zbatohet për të gjitha çështjet që janë në gjykim, duke vendosur nxjerrjen e tyre jashtë juridiksionit gjyqësor. Dispozitat procedurale të ligjit të ri shfuqizojnë të gjitha pasojat procedurale të ligjit të mëparshëm të shfuqizuar. Ligji i ri duke parashikuar juridiksionin administrativ për shqyrtimin paraprak të këtyre çështjeve nuk e shmang juridiksionin gjyqësor, i cili mund të ushtrohet pasi të jetë ezauruar më parë shqyrtimi në juridiksionin administrativ.

Shumica shprehet se kur çështja hyn në juridiksionin gjyqësor në kushte ligjore, ajo nuk mund të dalë nga ky juridiksion. Ky pohim do të ishte i drejtë vetëm në qoftë se ligji i ri do të parashikonte vetëm juridiksionin administrativ dhe do të shmange tërësisht juridiksionin gjyqësor. Vetëm në këtë rast, siç shprehet shumica, do të krijohej një precedent i rrezikshëm që me akte normative të zgjidhen çështjet, tashmë në juridiksionin gjyqësor, nga organe të tjera jashtë këtij juridiksioni.

Shumica shtron pyetjen se si do të veprohej në ato raste kur gjykatat nuk e nxjerrin çështjen jashtë juridiksionit, por e konsiderojnë atë në juridiksionin e tyre dhe do të vazhdonin gjykimin? Përgjigja është e thjeshtë: Gabimi do të korrigjohej duke u shprehur dhe vendosur për juridiksionin gjykata më e lartë. Në këtë mënyrë do të sigurohej edhe uniformiteti në zbatimin e dispozitave juridiksionale.

Anëtarë: Zamir Poda, Thimjo Kondi, Nikoleta Kita, Ylvi Myrtja, Vladimir Metani, Irma Bala, Besnik Imeraj

Nr.12, datë 24.5.2005

**PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR CAKTIMIN E MANDATIT TË
FUNDIT NGA LISTAT SHUMEMËRORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË TË VITIT 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 67 pikat “b”, “ç”, “dh” dhe nenit 68 pikat “a” dhe “ç” të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat e organizimit të shortit, midis subjekteve zgjedhore që kanë mbetje dhjetore të barabarta, për caktimin e mandatit të fundit nga listat shumëmemërore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.

Neni 2

1. KQZ merr vendim për organizimin e shortit në rastet e parashikuara në nenin 67 pikat “b”, “ç” dhe “dh” dhe nenin 68 pikat “a” dhe “ç” të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Procedurat e shortit organizohen jo më herët se 5 ditë nga marrja e vendimit për shortin. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit shpallet në hyrje të KQZ-së.

Neni 3

1. Hedhja e shortit organizohet në seancë publike.

Neni 4

1. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, sekretari i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore përkatëse dhe i fton ato të zënë vendet e caktuara.

2. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në short.

3. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku në njërin prej tyre shënohet fjala “FITUES”.

4. Radha e tërheqjes së goglave sipas pikës 2, caktohet me short.

5. Sekretari i KQZ-së fton me radhë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore për tërheqjen e shortit.

6. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore midis të cilëve hidhet shorti, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast procedura për tërheqjen e shortit për subjektin në mungesë, bëhet nga një person i caktuar me vendim të KQZ-së.

Neni 5

1. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor që e hap gogllën, ia dorëzon sekretarit të KQZ-së, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.

2. Pasi është tërhequr gogla me shënimin “FITUES”, sekretari i KQZ-së i hap me radhë goglat e mbetura në enë, nëse ka, dhe lexon me zë të lartë përmbajtjen e fletëve dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 6

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KQZ-ja merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM

Nr.13, datë 26.5.2005

PËR PROCEDURËN E ORGANIZIMIT TË SHORTIT, PËR SHPALLJEN E FITUESIT MIDIS KANDIDATËVE QË KANË MARRË NUMËR TË BARABARTË VOTASH NË ZONËN NJËMËRORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 26.5.2005, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Illirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 66 pika 2 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1 Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që zbatohen për organizimin e shortit, për shpalljen fitues të kandidatëve që marrin numër të barabartë votash në zonën njëemërore.

Neni 2

KQZ merr vendim për organizimin e shortit për zgjedhjen e kandidatit fitues, në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numër të barabartë votash në zonën njëemërore ku ata kandidojnë. Vendimi përmban vendin, datën dhe orën e zhvillimit të shortit.

Neni 3

Mbledhja për hedhjen e shortit organizohet në seancë publike, jo më herët se 5 ditë dhe jo më vonë se 7 ditë pas marrjes së vendimit për hedhjen e shortit.

Neni 4

Njoftimi për zhvillimin e shortit shpallet publikisht në hyrjen e selisë së KQZ-së, si dhe botohet në dy gazetatat me tirazh më të madh.

Neni 5

1. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, sekretari i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e kandidatëve përkatës dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

2. Mosparaqitja e kandidatëve ose e njërit prej tyre nuk shtyn procedurat e shortit me përjashtim të rastit kur ndonjë prej tyre paraqet shkaqe të përligjura për mosparaqitjen. Në çdo rast shtyrja bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 48 orë.

3. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i kandidatëve, pjesëmarrës në short.

4. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku në njërin prej tyre shënohet fjala “FITUES”.

5. Radha e tërheqjes së goglave sipas pikës 3, caktohet me short.

6. Sekretari i KQZ-së fton me radhë kandidatët për tërheqjen e shortit.

Neni 6

1. Kandidati që e hap gogllën ia dorëzon sekretarit të KQZ-së, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në short.

2. Pasi është tërhequr gogla me shënimin “FITUES”, Sekretari i KQZ-së i hap me radhë goglat e mbetura në enë, nëse ka, lexon me zë të lartë përmbajtjen e fletëve dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në mbledhje.

Neni 7

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KQZ me vendim shpall rezultatin e shortit duke deklaruar kandidatin fitues.

Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM
Nr.14, datë 28.5.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 23.3.2005 PËR CAKTIMIN E VENDIT
TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËRGATITJES SË TYRE DHE MËNYRËN E NGRITJES
SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 95, nenit 95/1, nenit 95/2, nenit 109/3, nenit 109/4, nenit 109/5 dhe nenit 109/6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Në udhëzimin nr.4, datë 23.3.2005 ”Për caktimin e vendit të numërimit të votave, përgatitjes së tyre dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit”, në planvendosjen tip bashkëlidhur udhëzimit, bëhet një ndryshim sipas lidhjes bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.




LEGJENDA

EMERTIMI	NJESIA	SASIA
TAVOLINA PUNE	Cope	12
KARRIGE	Cope	60
SHIRIT NDARES	Meter	50
Pluritus	cope	2
FAKS	Cope	1
TABELA SQARUESE	Cope	10

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2005

PLANVENDOSJE TIP

E
VENDIT TE NUMERIMIT TE VOTAVE



UDHËZIM
Nr.15, datë 28.5.2005

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1, germa b, nenit 45 e vijues të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON :

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të KQV-ve, caktimin e rregullave për zhvillimin e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Komisioni i Qendrës së Votimit është organ kolegjal. Ai përgjigjet për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit.

2. KQV-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente. Të drejtat dhe detyrat e KQV-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

PJESA E II
PËRBËRJA E KQV

Neni 3
Ngritja e KQV-së

1. KQV-ja përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KZZ-ja vetëm për periudhën e zgjedhjeve. Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të nenit 34 të Kodit Zgjedhor.

2. KZZ-ja emëron anëtarët e KQV-së jo më vonë se pesë ditë nga paraqitja e propozimeve. Në çdo rast emërimi i tyre bëhet para datës 24 qershor 2005.

3. Anëtarët e KQV-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2005, propozohen nga partitë politike si më poshtë:

- 1 anëtar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Demokrate e Re;
- 1 anëtar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
- 1 anëtar nga Partia Republikane Shqiptare;
- Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KQV-ve nga Partia Socialiste, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Demokratike, në varësi të shortit të hedhur nga KZZ-ja.

4. Sekretari i KQV-së propozohet nga partia politike, e cila ka të drejtë të paraqesë propozimin për zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 4
Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. Propozimet për anëtarë të KQV-së paraqiten nga partitë politike të përcaktuara në nenin 3, pika 3 të këtij udhëzimi. Partitë politike mund t'ua delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të KQV-ve që përfshihen në territorin që mbulon dega lokale përkatëse.

2. Propozimi për anëtarët dhe sekretarin e KQV-së përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, adresën e vendbanimit, si dhe arsimin e personit që propozohet.

Neni 5

Caktimi i anëtarit të shtatë të KQV-së

1. KZZ-ja cakton me short partinë politike që ka të drejtë të propozojë anëtarin e shtatë.

2. Procedura e shortit është si më poshtë:

a) KZZ rendit duke nisur nga QV me numër më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës, të gjitha QV-të që ndodhen brenda zonës zgjedhore.

b) Në rastet kur një QV është krijuar rishtazi dhe ka numër pesëshifror, atëherë kjo QV renditet menjëherë pas QV, që ka numër të njëjtë me katër shifrat e para të QV-së së krijuar rishtaz.

c) KZZ emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër tek, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZZ-së.

d) KZZ emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër çift, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZZ-së.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të KQV-së

KZZ-ja, pasi konstaton se propozimet janë në përputhje me kërkesat e neneve 45/1 dhe 45/2 të Kodit Zgjedhor, emëron me vendim anëtarët e KQV-së. Për emërimin e tyre KZZ-ja përdor Modelin 17 V.

Neni 7

Emërimi i kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së

1. Për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së, KZZ-ja përdor Modelin 18 V.

2. Sekretari i KQV-së emërohet me propozim të partisë, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 8

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 45/3, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

2. Anëtari dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 45/3, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

3. Shkarkimi dhe lirimi bëhet me vendim të KZZ-së.

Neni 9

Plotësimi i vendit vakant

Kur vendi i një anëtari të KQV-së mbetet vakant, KZZ-ja i kërkon degës lokale të partisë politike përkatëse të paraqesë propozimin për anëtarin e ri. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas afateve

dhe kritereve të përcaktuara në nenin 45 pika 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor.

PJESA III

Neni 10

Detyrat e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.

2. Sekretari i KQV-së zbaton të gjitha detyrat sipas përcaktimeve të nenit 47 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.

Neni 11

Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretari i KQV-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

PJESA IV

MBLEDHJET E KQV-SË

Neni 12

Mbledhjet dhe vendimet KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.

2. Mbledhjet e KQV-së janë të vlefshme, kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të KQV-së. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

3. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën pro ose kundër, si dhe arsyetimin përkatës.

4. KQV-ja merr vendime tip, sipas përcaktimeve të nenit 48 pika 4 të Kodit Zgjedhor, duke përdorur modelet tip të vendimeve të miratuara nga KQZ-ja.

5. Të gjitha vendimet e KQV-së shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve të KQV-së.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdolloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 8.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë